



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

Nr. Prot. 070/B/12

VENDIMI Nr. 277

Për
'Miratimin e Doracakut dhe përcaktimin e kushteve dhe termeve
për
përdorimin e Platformës së WebGIS'

Në mbështetje të nenit 1 paragrafi (1) dhe (2), nenit 6 paragrafi (1) të Ligjit të Telekomunikacionin Nr. 2002/7, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-085 (tutje referuar - Ligji); Dokumentin e Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit; në përputhje me nenin 22 të Rregullores së Brendshme, Nr. Prot. 161/06, të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART), Bordi Drejtues i ART i përbërë nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar i Bordit
- 2) z. Besnik Berisha Anëtar i Bordit
- 3) z. Naser Shala Anëtar i Bordit
- 4) z. Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit

në mbledhjen e XXXX të Bordit të mbajtur me datë; 18 Tetor 2012, bazuar në shqyrtimin e materialeve të përgatitura dhe prezantuara nga Administratori i Rrjetit dhe GIS në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës pranë Departamenteve të ART-së;

- Raporti për operabilitetin e platformës (aplikacionit) WebGIS të datës; 18 Tetor 2012; dhe
- Doracaku mbi përdorimin e aplikacionit

Nga shqyrtimi i dosjes së lëndës, diskutimet si dhe duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat e paraqitura si në vijim Bordi Drejtues;

V Ë R E N se;

- (1) Operatorëve u është kërkuar nga ART që të caktojnë zyrtarët teknik përgjegjës për qasje operative dhe mirëmbajtje të shënimeve {*Ref. Shkresa për IPKO (ART Nr. Prot. 1209/2/12), datë; 07/06/2012; Shkresa për Artmotion (ART Nr. Prot. 1210/2/12) datë; 07/06/2012; Shkresa për Kujtesa.net (ART Nr. Prot. 1208/2/12) datë; 07/06/2012) dhe shkresa për PTK Sh.A. (ART Nr. Prot. 1207/2/12) datë; 07/06/2012*};

- (2) Përgjigjet e operatorëve lidhur me caktimin e zyrtarëve përgjegjës {Ref. IPKO (Shkresa/e-mail i datës; 20/06/2012); Artmotion (Shkresa/e-mail i datës; 20/06/2012); Kujtesa.net (Shkresa/e-mail i datës; 12/06/2012) dhe PTK sh.a. (Shkresa/e-mail i datës; 12/06/2012)};
- (3) Prezantimit të platformës softuerike të bërë me rastin e takimeve të zhvilluara me operatorët si dhe analizimit të të dhënave ekzistuese të operatorëve (Ref. Raporti i datës; 26/06/2012 i Grupit Punues të ART-së);
- (4) Trajnimit të zhvilluar për operatorët lidhur me përdorimin e platformës (Ref. Raporti i Grupit Punues të ART-së i datës; 23/08/2012).

A T Ë H E R Ë;

me qëllim dhe në funksion të përmbushjes së detyrave në vijim;

- i. Integrimit dhe shkëmbimit të të dhënave në gjeodatabazë për infrastrukturën e komunikimeve elektronike që posedojnë operatorët e licencuar nga ART;
- ii. Rritjes së efikasitetit nëpërmjet përdorimit të gjerë të sistemit të integruar informativ gjeografik për planifikim dhe vendimmarrje;
- iii. Inkurajimit të përdorimit të përbashkët të infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe përmirësimit e shfrytëzimit të kapaciteteve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike;
- iv. Arritjes së qëllimeve si të elaboruara me pjesën e arsyetimit të këtij aktvendimi;
- v. Zbatimit të dispozitave të legjislacionit të aplikueshëm të potencuara në pjesën e bazës ligjore;

atëherë, autoriteti ligjor, Bordi Drejtues i ART-së, nxjerr këtë;

V E N D I M

- I. Miratohet dokumenti ‘**Doracaku mbi përdorimin e Platformës WebGIS**’, i cili dokument edhe është pjesë integrale e këtij vendimi.
- II. Me fillim nga data; 01 Janar 2013 efektivisht u lejohet qasja në platformën WebGIS operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike; PTK Sh.A. (njësive Vala dhe Telekom i Kosovës), IPKO Telecommunications LLC, Kujtesa.net LLC dhe Artmotion, me të drejtat dhe detyrimet si në vijim;
 - a) Futjen e të dhënave për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike në formatin e kërkuar nga platforma dhe në përputhje me udhëzimet e specifikuara në dokumentin ‘Doracaku mbi përdorimin e Platformës WebGIS’;
 - b) Vizualizimin dhe disponueshmërisë e të dhënave të platformës për rrjetet publike të komunikimeve elektronike që janë në pronësi të tyre.
 - c) Operatorët do të kenë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre dhe përdorimin e të dhënave si dhe përgjegjësinë për saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit.
 - d) Secili operatorë mund të shoh vetëm shënimet e veta të vendosura në gjeodatabazë,

- e) Një përdorues mund të punojë në gjeodatabazë vetëm në shtresë/layer të ndryshëm,
 - f) Administratori i GIS-it në këtë rast ART mund të shohë shënimet e të gjithë operatorëve në gjeodatabazë.
- III.** Operatorët tjerë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, të cilët nuk janë referuar në pikën II të këtij vendimi dhe dëshirojnë të kenë qasje në platformë duhet të paraqesin kërkesë me shkrim pranë ART-së dhe Bordi Drejtues i ART-së brenda periudhës prej 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës do të marrë vendim për lejimin ose refuzimin e qasjes.
- IV.** Autorizohen zyrtarët përgjegjës të GIS-it pranë ART-së që të bëjnë verifikimin e saktësisë së të dhënave duke përfshirë edhe të dhënat mbi koordinatat gjeografike të vendosura në platformë nga operatorët.
- V.** Obligohen operatorët që t'i koordinojnë aktivitetet e tyre me administratorin e GIS-it lidhur me përdorimin dhe qasjen në platformë.
- VI.** ART mbulon të gjitha kostot e operimit të platformës me fondin e vet.
- VII.** Në rast të mos-përmbushjes së plotë të dispozitave të nenit II si të shpallur me dokumentin Doracakut të miratuar në pikën I të këtij aktvendimi, ART rezervon të drejtën e inicimit dhe ndërmarrjes së veprimeve tjera përfshi edhe shqiptimin e sanksioneve ekonomike në përputhje me dispozitat e akteve ligjore të aplikueshme.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në ueb faqen www.art-ks.org

ARSYETIM

Korniza aktuale rregullatore në fuqi;

- Ligji i Telekomunikacionit Nr.2002/7, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-085, nenet 13, 15, 22, 52, 53, 54 dhe 67,
- Dokumenti i politikave të Telekomunikacionit i datës 13/06/2007, pika 3.3 (*Rrjetat dhe teknologjia*), 3.6.2 (*E drejta për shteg*), dhe 3.7 (*Menaxhimi me resurset e kufizuara*),

e obligon ART që t'i mbrojë interesat e shfrytëzuesve të komunikimeve elektronike, promovojë dhe sigurojë konkurrencë të lirë dhe efektive, t'i nxisë investimet efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike brezgjëra në veçanti në zonat ku nuk ka shtrirje dhe konkurrencë të mjaftueshme.

Si rezultat, është imponuar nevoja e posedimit të të dhënave sa më të sakta për infrastrukturën telekomunikuese/komunikimeve elektronike, shtrirjen e kësaj infrastrukture, gjendjen e saj, kapacitetin dhe teknologjinë e përdorur nga operatorët.

Prandaj, ART me qëllim të jetësimit të obligimeve të specifikuara si në paragrafin e mësipërm, ka realizuar me sukses projektin e krijimit të sistemit informativ gjeografik (WebGIS), i cili do t'i

mundësojë ART-së të kryejë analiza dhe marrë vendimet adekuate sa i përket futjes së konkurrencës në drejtimet dhe kahet e duhura, si dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Vendimmarrja se ku duhet të shtrihet një rrjet apo shërbim i caktuar, me çfarë kualiteti dhe me çfarë përmbajtje janë vendime shumë të rëndësishme që duhet të bëjnë autoritetet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike gjatë përmbushjes së mandatit të tyre.

Objektivat e përgjithshme të projektit janë;

- Integrimi, mirëmbajtja dhe shkëmbimi i të dhënave për infrastrukturën telekomunikuese që e posedojnë të gjithë operatorët e licencuar nga ART në Republikën e Kosovës në një platformë të gjeodatabazës së të dhënave;
- Rritja e përfitimit dhe ngritja e efikasitetit të punës nëpërmjet përdorimit të gjerë të Sistemit të Integruar Informativ Gjeografik në ART për planifikim, vendimmarrje dhe menaxhim të aktiviteteve ditore; dhe
- Qasje gjithëpërfshirëse në këto të dhëna si dhe në procedimin/bashkë-shfrytëzimin e të dhënave nga ana e ART-së, si dhe entiteteve tjera.

Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një platformë mjaft komplekse, e cila si e tillë mund të zhvillohet në vazhdimësi (*open source*), si dhe faktit se krijimi i përdoruesve, respektivisht lejimi i qasjes për palët tjera, në veçanti operatorëve të rrjetit me shtrirje të gjerë/nacionale, është proces, i cili trajtohet ekskluzivisht në kuadër të kompetencave të ART-së varësisht nga ajo se cila është zgjidhje me efektive dhe lehtëson punën e ART-së drejt arritjes së qëllimit final;

Marrë në konsideratë konsultimet e bëra me përfaqësuesit e operatorëve të rrjetit dhe trajnimet e zhvilluara për përdorimin e aplikacionit, si dhe analizimit të të dhënave në dispozicion të operatorëve,

ART ka konsideruar si zgjidhjen më të mirë që gjatë kësaj faze t'u lejohej qasja operatorëve në platformë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara si në dispozitivin e këtij vendimi ashtu që operatorët t'i fusin të dhënat e tyre në platformë.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vërtetim:

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtinë, 16/11/2012

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

**Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit**

Besnik Berisha	Anëtar i Bordit
Naser Shala	Anëtar i Bordit
Nijazi Ademaj	Anëtar i Bordit

Aktivendimi i dërgohet;

- Operatorëve; PTK Sh.A., IPKO Telecommunications LLC, Kujtesa.net LLC, dhe Artmotion
- Departamentit të Telekomunikacionit, ART
- Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave, ART
- Arkivit të ART-së